



KOMUNIKATË 22.11. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur sot, është informuar për rrjedhën e procesit të numrimit që është duke u bërë në Qendren e Numrimit dhe të Rezultateve. Pasi që është aprovuar rendi i ditës, kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, ka kërkuar nga koordinatori i QNR-së z. Burim Ahmetaj, të paraqesë informatat më të reja lidhur me procesin e numrimit. Z. Burim Ahmetaj, e ka informuar KQZ-në se, procesi i numrimit të votave është në vazhdim dhe se ky proces, ka shënuar progres dhe se, janë duke u rinumruar vendvotimet në bazë të kërkesës së KZAP-it.

Është bërë rinumrimi në vendvotimin me numër 1304E/01R në komunën e Lipjanit (vendvotimi A nr. 98/ 2009). Është rinumruar vendvotimi 2305D/ 03D në komunën e Shtërpsës (Vendvotimi A nr. 144/2009). Gjithashtu, është bërë edhe rinumrimi për kuvendin komunal në vendvotimin me nr. 2305D/03D në komunën e Shtërpsës (vendi A nr. 144/2009), por ka mospërputhje dhe mungojnë 62 fletvotime.

Është bërë edhe rinumrimi për kuvendin komunal në vendvotimin nr.1304E/03D të komunës së Lipjanit (vendi A nr. 98/2009) dhe, ky vendvotim është në rregull. Në vendvotimin nr. 0213C/03 R të komunës së Gjakovës (vendi A nr. 98/ 2009) për kuvendin komunal, është bërë rinumrimi dhe sipas rinumrimit gjithçka është në rregull. Është rinumruar edhe vendvotimi nr. 3032a/02, në komunën e Malishevës. Në procesin e rinumrimit, është procesuar edhe vendvotimi nr. 0219c/01, 02, 03, 04 në fshatin Novosellë të komunës së Gjakovës. Gjithashtu, është rinumruar edhe vendvotimi nr. 0213C/01, 02, 03 në fshatin Demjan të komunës së Gjakovës, Vendvotimi nr. 2209e/01r dhe 02r në fshatin Pjetreshticë të komunës së Shtimes, është në rinumrim e sipër. Anëtarët e KQZ-së, e kanë dëgjuar me vëmendje raportin për rinumrim të vendvotimeve dhe i kanë shtruar pyetjet e tyre, syzjerimet dhe vërejtjet për raportin.

Koordinatori i QNR-së z. Burim Ahmetaj, ka bërë 6 rekomandime të ekipit hetues të QNR-së për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në vendvotimin 2202e/04d në komunën e Shtimes, është rekomanduar që të rinumrohet kutia për kryetar komune. KQZ e ka miratuar këtë rekomandim por ka kërkuar që të bëhen përmirësime në formulimin e tij. Lidhur me rekomandimin e vendvotimit 2204e/04r të komunës së Shtimes për shkak se FRP për kryetar komune është e zbrazët, KQZ ka kërkuar që ky rekomandim të qartësohet më mirë. Në vendvotimin 2204/ 04d (Shtime), FPR për kryetar komune ka qenë në rregull, dërsa FPR për kuvend komunal nuk ka mundur të zgjidhet sepse është vendvotim i dyfishtë dhe, materiali nuk mund të jetë i ndarë. Rekomandimi është bërë që të rinumrohen fletvotimet për kuvend komunal dhe t'u bashkangjiten fletëvotimeve të rregullta.

Vendvotimi 1805e/02d nga komuna e Podujeves, nuk është gjetur në FRK dhe i është rekomanduar KQZ-së që ta miratoj kërkesën që kutia të procesohet pa FRK, dhe që mos t'u jepet asnjë votë kandidatëve. Në vendvotimin 2102b/02d të Skenderajt, mungon thesi i ZFK-së prandaj, rekomandohet që FPR-të të procesohen por, kutitë mbesin në hetim. Në vendvotimin 1101b/02d të komunës së Mitrovicës, nuk ka pasur votues dhe është rekomanduar që ky vendvotim të fshihet nga data baza.

Komisioni në bazë të analizave të bëra, me vendime i ka miratuar rekomandimet e QNR-së. Z. Burim Ahmetaj, ka raportuar edhe kërkesën e KZAP-it që të lejoj ekipin hetues të QNR-së që të bëj hapjen e kutive të votimit për të gjetur materialet të cilat mungojnë për të kompletuar procesimin e tërë materialeve. KQZ ka marrë vendim që t'i lejohet KZAP-it të bëj hapjen e kutive. Koordinator i QNR-së z. Burim Ahmetaj, e ka informuar KQZ-në se është shënuar progress edhe në numrimin e votive me kusht, si dhe të atyre me postë ndërsa, prej 91 kutive që janë në karantinë, 39 prej tyre janë hetuar.